KOMUNIKATË PËR MEDIA (E TRETA NGA LABORATORI ORA 23.34)

Në Kosovë nuk ka koronavirus!

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë
Publike sot në mbrëmje ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK për një
pacient të kthyer nga Italia i hospitalizuar në Klinikn Infektive, SHSKUK.

Pacienti u vizitua nga ekipi i
infektologëve në Klinikën Infektive, u morë mostra për testim laboratorik në virus
SARS-CoV-2.

Ekipi i Laboratorit të
Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK ka bërë testimin në virus SARS-CoV-2 te
pacienti A.B. me metodën rRT-PCR dhe testi ka rezultuar negativ domethënë pacienti
nuk është të infektuar me virusin SARS-CoV-2.